

**VENDIM**  
**Nr. 670, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 87, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR  
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT/RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË  
BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË  
BASHKINË MIRDITË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 87, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 69 904 472 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**